



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 568/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Ankimues: Operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Muhamet Gjollesha”, Zogu i Zi, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore
Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 84, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor e më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar shkallët e ankimit, duke mos plotësuar kushtet formale të paraqitjes të ankesës.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.07.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

II.2. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k., KPP vëren se: Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 12.11.2020, ka dorëzuar ankimin drejtuar autoritetit kontraktor,

me anë të të cilit kërkon modifikimin e shtojcës për ndryshimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën ankimuesit me anë të shkresës nr.3105/43, datë 16.11.2020, duke mos e pranuar atë për shkak të mospërmbushjes të kushteve formale.

II.4.Në datën 25.11.2020, operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Në datën 27.11.2020, me anë të vendimit Nr.1569/1 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi: Pezullimin e procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si dhe ka kërkuar nga autoriteti kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit dhe fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë, shoqëruar me procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të dokumentave të tenderit, kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike, argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe informacion i hollësishëm vërtetuar me dokumentacion për dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e saj.

II.6.Në datën 10.12.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3105/49prot., datë 07.12.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kushteve formale të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Në datën 28.07.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

III.1.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k., KPP vëren se: Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se në datën 12.11.2020, ka dorëzuar ankimin drejtuar autoritetit kontraktor, me anë të të cilit kërkon modifikimin e shtojcës për ndryshimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën ankimuesit me anë të shkresës nr.3105/43, datë 16.11.2020, duke mos e pranuar atë për shkak të mospërmbushjes të kushteve formale.

III.1.3. Në datën 25.11.2020, operatori ekonomik “Dynamicx Group” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.1.4 Në datën 27.11.2020, me anë të vendimit Nr.1569/1 Protokolli, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi: Pezullimin e procedures së prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si dhe ka kërkuar nga autoriteti kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit dhe fazën në të cilën ndodhet kjo procedurë, shoqëruar me procesverbalin e hartimit dhe argumentimit të dokumentave të tenderit, kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve teknike, argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe informacion i hollësishëm vërtetuar me dokumentacion për dorëzimin e ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimin e saj.

III.1.5. Në datën 10.12.2020, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3105/49prot., datë 07.12.2020, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar, me anë të të cilit Komisioni informohet si më poshtë vijon:

“[...]Ankesa e OE Dynamicx Group sh.p.k. nuk është paraqitur konform nenit 78, pika 2 e VKM-së 914, dt.29.12.2014, i ndryshuar, pra ankesa nuk është paraqitur në rrugë shkresore sic parashikohet në VKM dhe në Manualin nr.02, datë 06.02.2018...[...]”

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1.1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht: “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të*

jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.”. Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78 pika 4, gërma, përcaktohet se: “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të APP-së. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas parashikimeve të LPP. Autoriteti kontraktor duhet të nxjerrë një vendimi brenda 3 (tri) ditëve nga data e depozitimit të ankesës”. Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike”

III.1.7. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit me shkrim, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, dorëzimi dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj., por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se dorëzimi i ankesës me mjete elektronike nuk gjen zbatim në kuptim të LPP-së.

III.1.8. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues nuk ka depozituar pranë autoritetit kontraktor një ankesë të hartuar në formën e përcaktuar në ligj – *formë shkresore*, ç’ka rrjedhimisht sjell që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e të gjitha shkallëve të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, që referuar nenit 26, pika 3, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, e cila përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kushteve formale të saj.

III.1.9. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiteti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në thellim të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve të ankimit sipas kushteve formale që duhet të

ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Dynamicx Group” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje pulla kontrolli me elemente sigurie për barna dhe aksesore për shtypjen e tyre*”, me nr. REF-66914-07-27-2020, me fond limit 39,480,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.11.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1569 Protokolli, Datë 25.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri